



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS  
KOMISIONI I KONKURRENCËS

Nr. 96/ prot.

Tiranë, më 26.09.2025

189

VENDIM

Nr. 1215, Datë 26.09.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS NR. 1171, DATË 26.03.2025 "PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT TË THELLUAR NË TREGUN E NDËRMJETËSIMIT PËR SIGURIMIN E JETËS PËR KREDITË TË CILAT KËRKOJNË SIGURIM JETE PËR NDËRMARRJET: OTP BANK ALBANIA SHA, BANKA KOMBËTARE TREGTARE SHA, CREDINS BANK SHA, BANKA RAIFFEISEN SHA, BANKA E TIRANËS SHA, INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA SHA, UNION BANK SHA, E-BUSINESS SOLUTIONS SHPK, BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SHA, BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA DHE ABI BROKER SIGURIMESH SHA DHE NË TREGUN E KREDIDHËNIES ME SIGURIM JETE PËR KREDITË QË JEPEN BRENDA BANKËS BANKËS SË PARË TË INVESTIMEVE SHA DHE BANKËS PROCREDIT SHA"**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

|      |                |            |
|------|----------------|------------|
| Z.   | Denar BIBA     | Kryetar    |
| Znj. | Leida MATJA    | Zv/Kryetar |
| Z.   | Durim KRAJA    | Anëtar     |
| Znj. | Fatjola DELIJA | Anëtar     |

Në mbledhjen e tij të datës 26.09.2025 ,shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1171, datë 26.03.2025 "Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA".

**Bazë ligjore:** Neni 4, neni 9, neni 24, germa (d), neni 26 dhe neni 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës".

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

## **VËREN SE:**

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar për të vlerësuar sjelljen e bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi.
2. Për realizimin e procedurave hetimore bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, janë kërkuar të dhëna dhe informacione nga bankat e nivelit të dytë si dhe nga shoqëritë e sigurimit për vlerësimin e konkurrencës në tregun në tregun e sigurimit të jetës për kredi.
3. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar janë realizuar komunikime të vazhdueshme me bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e sigurimit dhe kredimarrësit, si në formë shkresore ashtu edhe përmes intervistave e inspektimeve. Shumë nga përgjigjet e ardhura kanë qenë jo ezauruese për Sekretariatit e Autoritetit, çka ka detyruar të rikërkohej informacion dhe të bëhen kërkesa për saktësim ose plotësim të të dhënave të paraqitura.
4. Koha e mbetur pas depozitimit të informacionit rezulton e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe analizimin e sjelljes së bankave në tregun e sigurimit të jetës për kredi, duke e bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1171, datë 26.03.2025.
5. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraparak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimarrje objektive.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 9, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 43, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

## **VENDOSI:**

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 1171, datë 26.03.2025 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker

Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA”, pika “III”, të ndryshohet si vijon:


*“III. Raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 10 Tetor 2025.”.*

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### KOMISIONI I KONKURRENCËS

**Leida MATJA**  
()  
**Zv/Kryetar**

**Durim KRAJA**  
()  
**Anëtar**

**Fatjola DELIJA**  
()  
**Anëtar**

**Denar BIBA**  
()  
**Kryetar**

